

A K T - T H E M E L I M I
(K O N T R A T Ė)
P Ë R
THEMELIMIN E SHOQËRISË TREGTARE ME
PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“OPEN BUS ALBANIA” SH.P.K

Bazuar në ligjin 9901 dt 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqeritë tregtare” i ndryshuar nëpërmjet Ligjit 129/2014 datë 02.10.2014, dhe të akteve të tjera ligjore dhe nënligjore, që rregullojnë fushën e rregjistrimit, licensimit dhe funksionimit të subjekteve tregtare në Republikën e Shqipërisë, në Tiranë, sot, më datë 16.01.2025, unë Erald Dervishi, lindur në Lushnjë, më 19.07.1987 dhe banues në Tiranë, shtetas Shqiptar, mbajtës i Pasaportës/ID me nr: I70719121V, madhor e me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, me vullnetin tim të lirë, në cilësinë e ortakut themelues, pasi themelova shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “**Open Bus Albania**” **SH.P.K** shpall statutin e shoqërisë tregtare si më poshtë vijon:

FORMIMI

Neni 1

Formohet shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin “**Open Bus Albania**” **SH.P.K** me një ortak themelues:


- Erald Dervishi, lindur në Lushnjë, më 19.07.1987 dhe banues në Tiranë, shtetas Shqiptar, mbajtës i Pasaportës/ID me nr: I70719121V.

Neni 2

Shoqëria tregtare “**Open Bus Albania**” **SH.P.K** do të ketë selinë në: Autobus Targa AB204JC, Tiranë.

Veprimtaria e saj do të jetë me kohë të pacaktuar.

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj ekonomike në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe në cdo shtet tjeter të huaj, me miratimin e asamblesë së përgjithshme të ortakëve dhe në përputhje me ligjet e vendit apo shtetit përkatës ku do ta ushtrojë këtë veprimtari, duke zbatuar të gjitha dispozitat ligjore të vendit ku do të ushtrojë veprimtarinë e saj.



Neni 3

Shoqëria është person juridik shqiptar.

Veprimitaria e saj zhvillohet sipas dispozitave të legjislacionit shqiptar, sipas kësaj kontrate dhe statutit të shoqërisë te cilat janë akte ligjore të pandashme.

Shoqëria është me përgjegjësi të kufizuar dhe përgjigjet vetëm për pasurinë e saj dhe në asnjë rast nuk përgjigjet për detyrimet e ortakut/ortakëve jashtë kushteve të kësaj kontrate. Gjithashtu dhe ortaku/ortakët nuk përgjigjen personalisht për detyrimet e shoqërisë dhe nuk ngarkohen në asnjë rast për detyrimet jashtë kuotës së tyre në krijimin e shoqërisë, apo asaj që do të posedojnë në të ardhmen, përveç rasteve kur ai/ata vullnetarisht marrin përsipër për një gjë të tillë.

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Neni 4

Objekti i veprimtarisë së shoqërise tregtare “**Open Bus Albania Albania**” SH.P.K është:

- Agjenci turistike. Ture turistike. Makina me qera. Transport udhetaresh brenda dhe jashte vendit. Transport turistik detar. Reklamime per vete dhe per te trete me sherbime te drejtperdrejta apo ne astete e kompanise. Shitje-blerje automjetesh, etj.

Veç sa më sipër në shoqëri do të zhvillohet çdo aktivitet tjeter që vetëm ose së bashku me veprimtarinë kryesore të lartpërmendur, do të vlerësohen si të favorshme për zhvillimin, forcimin dhe rritjen e gjendjes ekonomike e financiare të saj.

Neni 5

Kapitali themelor i shoqërise është caktuar në shumën 100.000 lekë dhe përbëhet nga 1 kuotë me vlerë nominale totale prej 100.000 lekë.

Kapitali themelor, kontribuohet prej ortakut themelues, i takon ortakut si më poshtë:

- Ortaku, Erald Dervishi kontribuon, dhe posedon 1 kuotë me vlerë nominale 100.000 lekë,

Ortaku i shoqërisë do të derди në llogaritë bankare të saj, shumën e përcaktuar më sipër, brenda 90 ditëve nga data e rregjistrimit të shoqërisë në rregjistrin tregtar pranë QKB.

Neni 6

Shoqëria fillon veprimtarinë e saj tregtare pas rregjistrimit të saj si person juridik dhe në rregjistrin tregtar pranë QKB.

Të ardhurat neto pas veçimit të fondeve si më sipër dhe shlyerjes së detyrimeve fiskale i mbeten për përdorim ortakëve të shoqërisë të cilët i ndajnë midis tyre në përputhje me vendimin e Asamblesë së ortakëve për caktimin e fitimeve.

Vendimi për caktimin e fitimeve (për shpérndarjen e fitimeve, për caktimin e rezervave apo mosshpérndarjen e fitimeve të vitit ushtrimor apo dhe fitimeve të mbartura), do të merret në çdo rast në mbledhjen përkatëse të asamblese së ortakëve të shoqërisë, me miratimin në mënyrë unanime me 100% të të gjithë kuotave të shoqërisë.

Asambleja e ortakëve mund të vendosë që të shpérndahen shumat e fondeve të rezervuara duke treguar shprehimisht llojin e rezerves ku janë marrë.

Fitimet neto të realizuara nga veprimtaria e shoqërisë si dhe shumat e fondeve të rezervuara, do të përdoren lirisht nga ortakët/ortaku i saj. Ortakët/ortaku do t'i disponojnë lirisht fitimet neto të shoqërisë si dhe shumat e fondeve të rezervuara, pas vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, për shpérndarjen e tyre. Ortakët e shoqërisë nëpërmjet vullnetit të tyre të shprehur me shkrim, janë autoriteti i vetëm ligjor apo ekzekutiv, që vendos dhe vepron, në lidhje me caktimin e fitimeve neto të shoqërisë apo shumave të fondeve të rezervuara, për shpérndarjen ose jo të tyre, për investimin ose jo të tyre, si dhe për mënyrën e ndarjes së tyre midis ortakëve të shoqërisë.

Në cdo rast, dhe rast pas rasti, fitimet neto të shoqërisë apo shumat e fondeve të rezervuara, do të shpérndahen midis ortakëve të saj, në raportet që ortakët e shoqërisë, do të miratojnë në mënyrë unanime, me 100% të kotave të kapitalit të shoqërisë, pas analizave vjetore të aktivitetit tregtar dhe financiar të shoqërisë duke marrë në konsideratë edhe performancën e ortakëve në funksion të realizimit të fitimeve të shoqërisë, pavarësisht raportit të kuotave që ortakët kanë apo do të kenë në të ardhmen në shoqëri.

Ortakët e shoqërisë, nëpërmjet këtij statuti të shoqërisë, jepin miratimin e tyre të plotë dhe të parevokueshëm, për mënyrën e ndarjes së fitimit neto të saj, të përcaktuar si më sipër në këtë nen, duke hequr dorë dhe njëkohësisht duke humbur çdo të drejtë të tashme dhe të ardhme, për të pretenduar ndryshe nga sa është përcaktuar në të.

Cdo ortak ka të drejtën e transferimit jashtë vendit të pjesës së fitimit duke zbatuar dispozitat ligjore për këtë transferim.

Neni 7

Organet drejtuese të shoqërisë janë: **Asamblea e Pergjithshme & Administratori** Asambleja e shoqërisë përbëhet nga Ortaku i vetëm i saj, dhe Administrator i shoqërisë është Z. Elidon Kapllani.

Mënyra e formimit dhe funksionimi i këtyre organeve përcaktohen me statutin e shoqërisë.

Neni 8

Ortaku/Ortakët detyrohen të ruajnë karakterin e fshehtësisë të gjithë dokumentacionit, informatave, etj. Duhet të merren masa të plota për të shmangur përhapjen e cdo të dhëne që ka të bëjë me shoqërinë dhe që vlerësohet si sekret tregtar në bazë të dispozitave ligjore në fuqi në vendin e ushtrimit të aktivitetit.

Neni 9

Shoqëria mund të kryejë cdo veprim juridik që ka të bëjë me objektin e veprimitarisë së saj.

Neni 10

Kjo kontratë lidhet për një periudhë kohe të pacaktuar. Ky afat mund të ndryshojë me vendim të organit kompetent në përputhje me statutin e shoqërisë dhe me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 11

Dispozita të hollësishme për shoqërinë dhe funksionimin e saj përcaktohen në statutin e shoqërisë që i bashkangjitet dhe është pjesë përbërëse e kësaj kontrate.

Mosmarveshjet që mund të lindin midis palëve në se nuk gjejnë zgjidhje me bisedime e mirëkuptim, do të zgjidhen në Gjykatën e Shkallës së Parë, Tiranë.

Neni 12

Kjo kontratë u përpilua në katër kopje të njëjtë në gjuhën shqipe duke depozituar kopjen në QKB përkryerjen e procedurave te rregjistrimit ne Rregjistrin Tregtar pranë saj, si dhe në cdo organ që kërcohët sipas ligjeve në fuqi.

Tiranë më, 16 Janar 2025.

ORTAKU THEMELUS:

Erald Dervishi

